



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. _____ Prot

Tiranë, më _____. _____. 2025

Lënda: Propozohet për shqyrtim dhe miratim një projektligj.

Drejtuar: Z. Niko PELESHI
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

Këtu

I nderuar Kryetar,

Në mbështetje të nenit 81, pika 1 të Kushtetutës dhe nenit 68, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëlidhur gjeni për shqyrtim dhe miratim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, shoqëruar me relacionin përkatës, propozuar nga një deputete e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Ju lutem, marrjen e masave për nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji në Kuvendin e Shqipërisë, në përputhje me nenet 68 e vijues të Rregullores.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

JORIDA TABAKU

DEPUTETE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.01.1995 “KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 81, pika 1 dhe pika 2 të Kushtetutës, me propozimin e deputetes Jorida Tabaku,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 237, pas paragrafit të pestë, shtohet paragrafi i gjashtë, me përmbajtje si më poshtë vijon:

Kur kjo vepër kryhet kundër gazetarit ose punonjësit të medias, për shkak të ushtrimit të veprimtarisë së tij profesionale në funksion të interesit publik dhe kur cilësitë e personit janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Neni 2

Në nenin 238, pas paragrafit të pestë, shtohet paragrafi i gjashtë, me përmbajtje si më poshtë vijon:

Kur kjo vepër kryhet kundër gazetarit ose punonjësit të medias, për shkak të ushtrimit të veprimtarisë së tij profesionale në funksion të interesit publik dhe kur cilësitë e personit janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Niko PELESHI

Miratuar, më ____ . ____ .2025

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.01.1995 “KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Liria e medias dhe e drejta për t'u informuar përbëjnë dy prej shtyllave themelore të shtetit të së drejtës dhe të një shoqërie demokratike funksionale. Për këtë arsye, çdo nismë që synon forcimin e zbatimit praktik të këtyre parimeve duhet të marrë mbështetjen e duhur të pushtetit ligjvënës.

Gazetarët në Shqipëri, siç evidentohet nga raportet e organizatave vendase dhe ndërkombëtare, vijnë në ushtrinë profesionin e tyre në një mjedis gjithnjë e më sfidues, të shënuar nga rritja e kërcënimeve, presioneve dhe formave të ndryshme të intimidimit. Megjithatë ekziston një kuadër i qartë kushtetues dhe ligjor që garanton lirinë e shprehjes dhe të medias, realiteti i përditshëm i punës së gazetarëve mbetet kompleks dhe shpesh i pasigurt, duke reflektuar një hendek të ndjeshëm midis normës dhe praktikës.

Një prej formave më të dukshme të presionit, që synon të prodhojë efekt censurues, janë paditë penale për shpifje, të njohura si paditë SLAPP (Strategic Lawsuit Against Public Participation). Ky fenomen është nënvizuar në mënyrë konsekuente në progres-raportet vjetore të Komisionit Evropian, raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit dhe ato të Këshillit të Evropës, të cilët rekomandojnë forcimin e mbrojtjes ligjore për gazetarët dhe median, si dhe dekriminalizimin e shpifjes.

Në funksion të përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian të Shqipërisë, vlerësohet e nevojshme ndërhyrja në Kodin Penal përmes disa shtesave dhe ndryshimeve. Këto ndërhyrje synojnë, nga njëra anë, të forcojnë mbrojtjen ligjore të gazetarëve dhe punonjësve të medias ndaj sulmeve fizike, verbale dhe kërcënimeve serioze për jetën dhe shëndetin e tyre.

Qëllimi i tij është të mbrojë gazetarët nga përpjekjet e strukturuar për t'i censuruar ose intimiduar, ndërkohë që vetë komuniteti mediatik duhet të vijojë të forcojë më tej vetërregullimin, ashtu siç rekomandohet nga Komisioni Evropian dhe Këshilli i Evropës.

Njëkohësisht, shoqatat e medias, gazetarët dhe punonjësit e medias i kanë artikuluar në mënyrë të përsëritur këto problematika, duke kërkuar ndërhyrje ligjore. Ky projektligj synon të dëshmojë se Kuvendi i Shqipërisë i merr seriozisht këto shqetësime dhe është i përkushtuar ndaj garantimit të një mjedisi të shëndetshëm mediatik, thelbësor për funksionimin e demokracisë.

Përmes këtij projektakt synohet gjithashtu të nxisë debatin publik dhe institucional mbi nevojën për rishikimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor që lidhet me sigurinë dhe kushtet e punës së gazetarëve, ku siguria fizike, psikologjike dhe ligjore mbeten të pazëvendësueshme për të garantuar gazetari profesionale dhe media cilësore.

Projektligji është konsultuar paraprakisht me shoqatën “Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë” (AGSH), përfaqësuese e 200 gazetarëve dhe punonjësve të medias, anëtare e Federatës Evropiane të Gazetarëve.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Përmirësimi dhe avancimi i lirisë së medias dhe të drejtës së informimit kërkon krijimin e një mjedisi profesional të sigurt, ku gazetarët të kenë mundësi të ushtrojnë veprimtarinë e tyre pa frikë nga dhuna apo presionet. Me këtë synim, projektligji njeh gazetarët si një kategori që kërkon mbrojtje të veçantë në rastet e sulmeve fizike, kërcënimeve ndaj jetës dhe shëndetit, apo çdo forme tjetër intimidimi.

Konkretisht, në nenin 237 të Kodit Penal që sanksionon dënimin penal ndaj kujtdo që cënon integritetin fizik të një punonjësi që kryen një detyrë shtetërore apo shërbim publik, propozohet të shtohet një paragraf i veçantë, i cili parashikon dënimin penal nga një deri në pesë vite burgim, për çdo person që ndërmerr akte dhune ndaj gazetarëve për shkak të veprimtarisë së tyre, kur cilësitë e tyre janë të dukshme ose të njohura.

Po ashtu, në nenin 238 që sanksionon dënimin penal ndaj kujtdo që kërcënon seriozisht jetën dhe shëndetin e një funksionari publik, propozohet të shtohet një paragraf i veçantë, i cili parashikon dënimin penal nga një deri në tre vjet burgim, për çdo person që kanos seriozisht për vrasje apo plagosje të rëndë një gazetar apo punonjësi të medias për shkak të veprimtarisë së tyre dhe kur cilësitë e tyre janë të dukshme apo të njohura.

III. VLERESIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është propozim i një deputeteje të Kuvendit të Shqipërisë, në përputhje me nenin 81, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, dhe nenin 68, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë. Siç kemi shpjeguar më lart, projektligji është në harmoni me 22 dhe 23 të Kushtetutës së Shqipërisë, si dhe nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

IV. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga tre dispozita.

E para, sjell shtimin e një paragrafi, në përmbajtje të nenit 237 “*Goditja për shkak të detyrës*”, të Kodit Penal, që sanksionon dënimin me burgim nga një deri në pesë vjet për çdo person që ushtron dhunë fizike ndaj një gazetari apo punonjësi të medias.

E dyta, sjell shtimin e një paragrafi, në përmbajtje të nenit 238 “*Kanosja për shkak të detyrës*”, të Kodit Penal, që sanksionon dënimin me burgim nga një deri në tre vjet për çdo person që kërcënon seriozisht me vrasje apo për plagosje të rëndë një gazetar apo punonjësi të medias.

Ndërsa, neni i tretë parashikon hyrjen në fuqi, në përputhje me përcaktimin e bërë në nenin 84, pika 3 të Kushtetutës së Shqipërisë.

**V. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
BUXHETORE**

Projektligji nuk sjell efekte financiare për Buxhetin e Shtetit.

JORIDA TABAKU

DEPUTETE

